



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

Proces-verbal

Takim pune i përfaqësuesve të shoqërisë civile
Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile

I mbajtur sot më datë 18.05.2017, pranë ambienteve të Kryeministrit.

Takimi i punës së Këshillit me përfaqësuesin e Kryeministrit, z. Ergis Sefa, filloi në orën 11:10.

Prezenca e anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së:

1. Znj. Afërdita Seiti
2. Z. Ali Coka
3. Z. Blendi Dibra
4. Z. Ergys Gezka
5. Z. Luan Ahmetaj
6. Znj. Mirela Juka (në mungesë të znj. Emanuela Zaimi)
7. Z. Vladimir Thanó
8. Znj. Zana Vokopola

11:15. Takimin e hapi z. Ergis Sefa, i cili i bëri të ditur anëtarëve të KKSHC-së mbi temat e trajnimit në “Shkollën Shqiptare të Administratës Publike” në funksion të përmbushjes së pikave të Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile. Në këtë kuadër u përcaktua organizimi i dy trajnimeve ku i pari do të jetë trajnimi 12- ditor me temë: Sistemi I Planifikimit të Integruar (pika 2.4.1.) dhe I dyti do të jetë mbi Informimin Publik dhe do të mbahet nga përfaqësues të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (pika 2.4.5.).

11:21. Z. Dibra paraqet kërkesën e tij për zgjidhjen e problematikave të rimbursimit të udhëtimit dhe akomodimit për anëtarë të cilët vijnë nga rrethet dhe marrin pjesë në aktivitete të Këshillit dhe trajnimet e parashikuara.

11:23. Z. Sefa i bëri të ditur të pranishmëve se Strategjia Kombëtare është në hapat e parë dhe se kërkohet nga KKSHC të përgatisë ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

11:25. Pjesëmarrësit diskutuan mbi finalizimin e Draftit të Rregullores së KKSHC-së ku u caktua dërgimi i modelit të parë dhe pritja e konfirmimeve. Gjithashtu, u diskutua edhe zgjedhja e Zv./Kryetarit të KKSHC-së.

11:30. Z. Sefa shpërndau për të të pranishmit një përmbledhje të zhvillimeve më të fundit (Fact-sheet) mbi Zbatimin e Udhërrëfyesit ku u paraqit ideja e ndryshimit të afateve për zbatim të saj.

11:40. Më pas z. Sefa u angazhua për caktimin e një date për zhvillimin e mbledhjes së KKSHC-së.

11: 55. Z. Sefa bëri të ditur mbi ngritjen e disa grupeve ndër-institucionale me afat funksional në të cilin do të adresohen çështjet e organizatave të shoqërisë civile, si kuadri ligjor, tatimet etj..

12:03. Z. Sefa vuri në dijeni të pranishmit mbi programet IPA dhe se do të ofrohet asistencë për Udhërrëfyesin.

12:07. Më pas z. Sefa njoftoi dhe ftoi të anëtarët e KKSHC-së mbi mundësinë e dhënies së sugjerimeve dhe rishikimit të Udhërrëfyesit.

Mbledhja u mbyll në orën 12:15.